

ALARM 35

20 KËRKESA PËR MBAJTJE TË ZGJEDHJEVE TË DREJTA DHE DEMOKRATIKE PARLAMENTARE TË PARAKOHSHME në vitin 2016

Duke u nisur nga vërejtjet dhe rekomandimet e dhëna në raportet e misioneve mbikëqyrëse për zgjedhjet në vitin 2014 dhe obligimet e Dokumentin e Kopenhagës të OSBE-së nga viti 1990, me qëllim që të organizohen **zgjedhje të parakohshme parlamentare të drejta dhe demokratike në vitin 2016**, alarmojmë Komisionin Shtetëror Zgjedhor (KShZ) si organ përgjegjës për zbatimin e përgjithshëm të zgjedhjeve për nevojën e domosdoshme nga:



përgatitje dhe shpërndarje e udhëzimeve në kohë dhe të qarta tek komisionet zgjedhore për zbatim të njëtrajtshëm të procedurave gjatë zhvillimeve zgjedhore;



aftësimi i komisioneve zgjedhore për tejkalimin e situatave të kontestueshme dhe dilemave;



fushata për edukim të zgjedhësve ku do të theksohen shembuj që tregojnë manipulim me votuesit;



rritja e vetëdijes tek votuesit se votimi është personal, i lirë dhe i fshehtë; dhe



vëzhgimi prej në afërsie të madhe gjatë identifikimit të identitetit të votuesve nga ana e vëzhguesve të akredituar.

KShZ ka përgjegjësi, nëpërmjet udhëzimeve dhe qartësimeve me shkrim, të përcakton aspektet e legjislaturës zgjedhore dhe për këtë shkak kërkojmë:

1. Qartësim me shkrim mbi Këshillat zgjedhor (KZ) dhe se kanë të drejtë **të largojnë secilin person i cili gjatë votimit përdor telefon celular ose aparat për fotografim të fletëvotimit**;
2. Procedurë precize tek Komisionet zgjedhore komunale dhe KZ **për regjistrimin dhe votimin e zgjedhësve që janë persona të pafuqishëm dhe të sëmurë**, gjegjësisht në udhëzimet duhet të shënohen tërësisht diagnozat e plota dhe përshkrimet e sëmundjeve që parandalojnë personin të votojë në ditën e zgjedhjeve, që pastaj komisionet lehtë do të krahasojnë me vërtetimet mjekësore me të cilat personat vërtetojnë sëmundjen;
3. Të siguron transparencë në procesin e përgatitjes së Kodeksit për zgjedhje të drejta dhe demokratike që e nënshkruajnë partitë politike, gjegjësisht dorëzuesit e listave, me të cilin padyshim detyrohen se nuk do të ushtrojnë **asnjë lloj shtypje ose përpjekje për shtypje tek të punësuarit** në administratën publike dhe shtetërore, në institucione tjera ose institucione të financuara nga Buxheti i RM, buxhetet e komunave dhe qytetit të Shkupit, si dhe në shoqatat tregtare dhe ndërmarrje me kapital shtetëror;
4. Udhëzime për **pranimin dhe ruajtjen e materialit për votim** para ditës së votimit dhe numërimi i domosdoshëm i fletëvotimeve para nisjes së votimit. Nevojitet njohje me vëzhguesit e akredituar dhe përfaqësuesit e dorëzuesve të listave, kohën e pranimit të materialit nga KZ dhe mënyrën se si ato do të veprojnë gjatë pranimit;
5. Fushatë për rritjen e vetëdijes së votuesve se **frikësimi i votuesve** nga ana e partive dhe organeve në pushtet, gjegjësisht **shkelja e lirisë së përcaktimit të zgjedhësve është akt penal**;
6. Kampanja për rritjen e vetëdijes tek votuesit se votimi **është personal, i lirë dhe i fshehtë**. Qytetarëve t'u theksohet se vetëm votuesi e dinë për kë do të votojë;
7. Fushatë për votuesit me fazat e votimit (për shembull, pasi të votojë pas paravanit zgjedhor votuesi duhet që **të vendos fletëvotimin e palosur të vendos në kutinë për votim**);
8. Këshillave zgjedhor duhet nëpërmjet udhëzimeve t'u theksohet obligimi që t'u sigurojnë përfaqësuesve të dorëzuesve të listave dhe **vëzhguesve të akredituar të ndjekin përcaktimin e identitetit të zgjedhësve** para se të zgjedhin nga afër;
9. Sqarim i publikuar për KZ me **fazat e votimit** (p.sh. fletëvotimi këputet nga koçani i bllokut me renditje numerike dhe **pastaj vuloset ana e përparme dhe i jepet zgjedhësit**);
10. Udhëzimi për KZ se për **fletë të vlefshme** konsiderohet secila fletë në të cilën është rrethuar numri rendor para dorëzuesit të listës, gjegjësisht numri rendor para kandidatit për të cilin është përcaktuar votuesi, si dhe fleta prej të cilës në mënyrë të qartë dhe padyshim mund të përcaktohet për cilën listë të kandidatit ka votuar votuesi;
11. Qartësim për KZ se **shkelja e fshehtësisë së votimit është shkak për anulimin e votimit** për vendvotimin nga ana e KShZ me detyrë zyrtare;
12. **Udhëzimet për KZ për anulim të fletëvotimeve të papërdorura** me grisjen e një pjese të fletave dhe vulosjen e tyre;
13. Udhëzime për KZ në rastet kur në vendin zgjedhor paraqitet **votues i cili deklaron se është analfabet**. KZ duhet të konsideron si analfabet vetëm personin që në dokumentin e identifikimit ka vendosur gjurmë gishti;
14. **Përkujtim publik për ndalesën për përdorimin e hapësirave të zyrave, pajisjes dhe automjetet zyrtare të organeve shtetërore në kampanjën zgjedhore**. Këto dispozita nga Kodi zgjedhor ti interpreton në mënyrë që do të parandalon konfliktin potencial të interesave mes pozitive të pushtetit ekzekutiv dhe pozitës së kandidatit;
15. Udhëzim për KZ për **votimin e zgjedhësve në arrest shtëpiak dhe zgjedhësve me nevoja të posaçme**;
16. Udhëzim për veprim të KZ gjatë **dëshimit të identitetit personal të zgjedhësit** në ditën e votimit. Nëse të dhënat për adresën në dokumentet personale të votuesve dallojnë nga ato të shënuara në Listën zgjedhore, kurse të dhënat tjera, përfshirë fotografinë përputhen, duhet t'u lejohet e drejta e realizimit të së drejtës për votim;
17. Fushata për edukim të votuesve me të cilën do të përfshihen rregullat e reja, gjegjësisht **aspektet e reja të procesit zgjedhor**;
18. Të siguron **monitorim qytetar të trajnimeve për Komisionet zgjedhore komunale** që i zbaton KShZ;
19. Të siguron **monitorim qytetar të trajnimeve për Këshillat zgjedhore që i zbatojnë Komisionet zgjedhore komunale**;
20. Qartësim për KZ për **të drejtën e pranisë së vëzhguesve të autorizuar gjatë përcaktimit të gjendjes në hapësirën dhe materialin zgjedhor** para nisjes së votimit.